

Elternbrief Albanisch / Letër për prindërit

Si i mëson fëmija im **2** gjuhët, gjermanishten dhe gjuhën e familjes?



Text: Dr. Michaela Ulich,
Përkthimin: Mahir Mustafa
Grafikën: Silvia Hüsler

**Staatsinstitut für Frühpädagogik – IFP
München**

Gefördert mit Mitteln des Bundesministeriums des Inneren
und des Bayerischen Staatsministeriums für Arbeit und Sozialordnung,
Familie und Frauen



Të dashur prindër,

Ndoshta ndonjëherë keni pyetur veten:

„Si mëson fëmija im gjermanisht?“

„A mundet fëmija im që i vogël të mësojë në dy gjuhë?“ ose

„A do të mund fëmija im të shprehet më vonë mirë – p.sh. në shkollë?“

Njëra ose tjetra pyetje është padyshim preokupim i shumë prindërve. Me këto pyetje janë marrë edhe shumë pedagogë e shkencëtarë, andaj lidhur me to dëshirojmë t’ju japim disa informata dhe këshilla.

Cilat janë nevojat e fëmijëve që ata të zhvillohen si duhet në aspektin gjuhësor?

- **Fëmijët i mësojnë mirë gjuhët e ndryshme**

Rritja e fëmijëve në dy gjuhë, p.sh. në shtëpi një gjuhë tjetër, kurse në kopshtin e fëmijëve gjermanisht, është një mundësi e mirë për të ardhmen e tyre. *Studimet shkencore dëshmojnë se fëmijët prej moshës së re (të vegjël) mund të mësojnë dy (bile edhe tri) gjuhë, në qoftë se ata kanë mbështetje të duhur.*

Në qoftë se nëna dhe babai flasin gjuhë të ndryshme, do të ishte mirë që secili prej tyre të flas në gjuhën e vet, sepse për fëmijët në përgjithësi, e veçanërisht për të vegjëlit, nevojiten rregulla të qarta në familje. Që fëmija ta mësojë e zotërojë një gjuhë mirë duhet t’i flitet gjithnjë në atë gjuhë, sepse fëmijët të mësuarit e një gjuhe e lidhin me personin që e flet atë. Kështu ata arrijnë ta dallojnë gjuhën që e flet babai prej asaj që e flet nëna dhe dijnë sakt se cila gjuhë përdoret p.sh. në tavolinë gjatë ushqimit.

- **Kopshti i fëmijëve është një mundësi e mirë për fëmijët**

Në kopsht fëmijët mësojnë gjermanisht dhe shumë gjëra të tjera të rëndësishme për zhvillimin e tyre gjuhësor, të cilat janë të rëndësishme për shkollimin e mëtejshëm. Kopshtit duhet të perceptohet si mundësi e mirë. Fëmijët duhet të shkojnë në kopsht prej moshës trevjeçare. Deri në klasën e parë të shkollës fillore fëmijët kanë mjaft kohë për ta përvetësuar gjermanishten. *Në kopsht edukatorët e ndihmojnë zhvillimin gjuhësor të fëmijëve me anë të lojrave, bisedave, këngëve dhe vjershave, librave me vizatime dhe tregimeve.*

Në qoftë se fëmija juaj nuk di gjermanisht, ai fillimisht në kopsht do të kërkojë kontakt me fëmijët që e flasin po të njëjtën gjuhë. Kështu ai do ta ndihmojë veten që të ndihet i lumtur. Me kalimin e kohës ai do të fillojë të shoqërohet edhe me fëmijët e tjerë gjermanofolës.

- **Cilën gjuhë e flisni ju me fëmijën tuaj?**

Disa herë prindërve u jepen këshilla të gabuara. P.sh. „Flisni me fëmijët tuaj gjermanisht në shtëpi, që pastaj ta kenë më lehtë në shkollë“. Kjo këshillë është e gabuar.

Flisni me fëmijët në gjuhën, të cilën e flisni spontanisht, natyrshëm dhe e dini më së miri. Si zakonisht kjo është gjuha amtare. Në gjuhën amtare ju posedoni më shumë fjalë dhe e njihni më mirë formimin e fjalive. Kështu fëmijët tuaj do të krijojnë një bazë gjuhësore, e cila u ndihmon atyre edhe për mësimin e gjuhëve të tjera, p.sh. gjuhën gjermane.

Derisa fëmija ta përvetësojë si duhet një gjuhë nevojitet shumë kohë. Kjo vlenë si për gjuhën amtare ashtu edhe për të gjitha gjuhët e tjera.

Lidhur me gjuhën dhe të folurit ka faza, në të cilat fëmijët preferojnë ta flasin vetëm një gjuhë – p.sh. vetëm gjermanishten. Në këtë fazë, edhe pse prindërit u flasin në gjuhën e tyre, ata përgjigjen vetëm gjermanisht. Këto faza duhet të shikohen si normale. Ju edhe më tej duhet të vazhdoni me ta të flisni në gjuhën tuaj. Ata duke e dëgjuar gjuhën që ju e flisni, nuk do të shkëputen prej saj. Më vonë i rikthehen asaj dhe e flasin.

• **Çka mund të bëni ju në familje që t’i mbështetni fëmijët tuaj në zhvillimin e tyre gjuhësor?**

Përditshmëria në familje është shumë e rëndësishme për zhvillimin e gjuhës. Fëmijët në familje e mësojnë gjuhën e parë.

Cilat janë në familje mundësitë konkrete për t’u ndihmuar fëmijëve në zhvillimin e gjuhës?

➤ **Gatishmëria dhe vullneti për të folur e treguar**

Gjuha nuk mund të trajnohet. Ajo te fëmijët e vegjël zhvillohet për çod ditë nga pak duke dëgjuar të tjerët dhe duke folur edhe vetë – p.sh. gjatë lojës, gjatë shikimit të librave me ilustrime, gjatë ushqimit, gjatë bisedave me njerëzit të cilët ata i duan. *Bisedat e përditshme janë shumë të rëndësishme për fëmijët. U tregoni fëmijëve për punën që ju bëni, për gjyshërit, për një përjetim tuaj të vogël që e keni pasur sot.* Lini ata që t’ju shikojnë kur përgatisni ushqimin në kuzhinë. Tregoni atyre se çka keni futur sot në tenxhere. Gëzohuni në qoftë se fëmijët tuaj shfaqin interes për gjërat që ju i bëni dhe në qoftë se ju tregojnë se çka i gëzon apo hidhëron ata, çka kanë thënë shokët në kopsht etj.

Duke treguar, fëmijët mësojnë të shprehën e ti shfaqin idetë e dëshirat me anë të fjalëve.

Fëmijët më së miri mësojnë atëherë kur ndjehen të lumtur dhe atëherë kur nuk kanë frikë nga gabimet. Disa herë fëmijët edhe zbulojnë fjalë fantastike. Ata luajnë me gjuhën, d.m.th me fjalët. Gëzimi që ndjejnë gjatë lojës u ndihmon atyre në zhvillimin e gjuhës.

Nuk do të ishte mirë për zhvillimin e tyre, në qoftë se kur ata gabojnë i korrigjoni. Nga korrigjimi i vazhdueshëm fëmijët e humbin gëzimin për të folur dhe treguar.

Për fat të mirë ekzistojnë disa veprimtari, me anë të të cilave fëmijët mësojnë dhe i zhvillojnë aftësitë gjuhësore, p.sh. leximi, tregimi, shikimi i librave me ilustrime, recitimi i vargjeve që rimojnë, këndimi etj.

➤ **Të shikuarit bashkërisht i librave me ilustrime**

Pë zhvillimin e aftësive gjuhësore të fëmijëve do të ishte mirë sikur prindërit për çdo ditë të shikonin e lexonin bashkë me ta libra me ilustrime. Të shikuarit, të lexuarit e librave me vizatime dhe diskutimet rreth tyre në gjuhën amtare u ndihmojnë fëmijëve që gjërat e mësuara t’i shfrytëzojnë më vonë në shkollë për mësimin e gjuhëve të tjera. Kjo çështje është e vërtetuar shkencërisht. Gjyshërit, vëllezërit e motrat më të mëdha, ose tezet e dajët, do të ishte mirë të gjejnë kohë për t’u lexuar apo për t’u treguar fëmijëve diçka.

Gjatë shikimit dhe leximit të librave me ilustrime është me rëndësi që:

- edhe fëmija edhe i rrituri të ndjehen të gëzuar (nëse i rrituri pyet për së tepërmi fëmijës i humbet vullneti për të lexuar apo dëgjuar)
- duke i shikuar vizatimet fëmija t’i interpretojë ato

Në qoftë se ju në shtëpi nuk keni libra me ilustrime dhe të tilla nuk mund të gjeni, i përdorni atëherë librat e shkruara në gjuhë të tjera, të cilat kanë pak tekst të shkruar. I shikoni ato dhe i diskutoni në gjuhën tuaj. Libra të këtilla mund të gjeni në libraritë ose në kopshtet e fëmijëve. Libra të tilla fëmijët mund të marrin edhe nga kopshtet dhe do të ishte mirë t'i shikojnë, lexojnë e diskutojnë bashkë me ju.

Fatmirësisht në librari të ndryshme tashti gjinden edhe libra të shkruara në dy gjuhë. Në qoftë se e zotëroni mirë gjermanishten mundet edhe tu lexoni herë në gjermanisht e herë-herë në gjuhën tuaj amtare.

Ndodh që fëmijët të shfaqin preferenca për librat, të cilat duan t'i kenë në duar më shpesh. Mos i pengoni, sepse edhe kjo u ndihmon në zhvillimin e gjuhës.

➤ **Rrëfimi i tregimeve**

Fëmijët i duan tregimet (përrallat). Duke dëgjuar përralla e tregime nga nëna, babai, daja ose gjyshi, fëmijët i zhvillojnë aftësitë e tyre gjuhësore. *Ata mësojnë t'i kuptojnë përmbajtjet e tregimeve dhe ua tregojnë edhe të tjerëve. Çështja e ritregimit të përmbajtjeve të dëgjura është me rëndësi të madhe për më vonë në shkollë.*

Tregimet mund të jenë nga jeta e përditëshme, mund të jenë përralla, tregime nga fëmijëria e juaj. Le të jenë tregime që u pëlqejnë fëmijëve. Si do të ishte p.sh. me një tregim (përrallë) për natë të mirë (vënie në gjumë)?

Edhe këngët e vargjet që rimojnë janë shumë të rëndësishëm për zhvillimin e aftësive gjuhësore. Fëmijët i duan shumë këto. A mbani në mend nodnjë vjershë ose strofa me vargje që rimojnë nga fëmijëria juaj?

➤ **Televizori nuk mjafton**

Gjatë shikimit të televizorit fëmijët koncentrohen kryesisht në fotografi dhe jo në atë se çka thuhet. *Shpeshherë fëmijët shikojnë televizor me zë të ulët. Shikimi i televizorit nuk është mjet mbështetës për zhvillimin e gjuhës.* Fëmijët mësojnë më shumë në qoftë se p.sh. e dëgjojnë një audiokasetë me një përrallë ose një tregim për natë të mirë të treguar nga prindërit. Në qoftë se fëmijët tuaj shikojnë televizor, atëherë do të duhej që pas mbarimit të filmit ose emisionit të shikuar të diskutoni me ta lidhur me përmbajtjen.

➤ **Fëmijët kanë nevojë për shembuj gjuhësor ngase ata rriten në dy gjuhë**

Shembujt më të mirë dhe më të rëndësishëm sa i përket zhvillimit të gjuhës janë padyshim prindërit. *Fëmijët i ndjejnë thellë p.sh. përpjekjet e prindërve të tyre për të mësuar gjermanisht.* Pyetni fëmijët tuaj për fjalët që ju nuk i dini në gjermanisht, ose shkoni në kurs të gjuhës. Kjo u ndihmon fëmijëve tuaj. Kur ju shohin juve duke bërë përpjekje për të mësuar gjermanisht, ata bëhen më kureshtar dhe janë më të motivuar për të mësuar gjermanisht. Fëmijët shumë shpejt e kuptojnë se sa e vlerësoni ju si prindër gjuhën amtare dhe sa e kuptoni rëndësinë e dygjuhësisë.

Gjuha është një thesar ...

Në qoftë se fëmijët tuaj flasin dy gjuhë dhe shprehen në të dyja, kanë krijuar një thesar, icli do t'u ndihmojë në jetë dhe profesion. Këtë thesar atyre nuk mund t'ua merr askush.

Juve dhe fëmijëve tuaj ju dëshirojmë shumë fat në këtë drejtim.